



Nr. 3218/1 Prot

Dt. 10.06.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Nr. 367/1 prot.

Shkodër, më 10.06.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 33, datë 26.05.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 18, 40, pika 4, neni 54, shkronja “dh”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë” i ndryshuar, neni 17, neni 44, paragrafi i dytë, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, të Udhëzimit Plotësues të MFE nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, të VKB Vau Dejës nr. 73, datë 23.12.2021 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Vau Dejës”, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 3214 prot., datë 01.06.2022 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 26.05.2022”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 33, datë 26.05.2022 “Për miratimin e rishpërndarjes të buxhetit të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2022”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI I BASHKISË



VENDIM

Nr. 33, datë 26.05.2022

PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES TË BUXHETIT TË BASHKISË VAU DEJËS PËR VITIN 2022.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 26.05.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9 pika 1.3 shkronja “c”, nenet 18, 54 shkronja “dh”, neni 55 pika 3, neni 64 shkronja “c”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; nenit 45 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; Ligji 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” neni 100 rishpërndarja e fondeve buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore: a) ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Vendim i Këshillit Bashkiak nr 72 prot me datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 12/1 prot dhe datë 14.01.2022. Udhëzim plotësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit 2022”. Sipas relacionit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e datës 26.05.2022 me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Miratimin e shpërndarjes së fondeve të trashguara të vitit 2021 sipas formatit nr 1.
2. Miratimin e rishpërndarjes së buxhetit të vitit 2022, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Formatit nr 2 Tansferta e Pakushtëzuar, të trashguar nga viti 2021
 - b) Formatit nr 3 Të Ardhurat e Bashkisë, të trashguar nga viti 2021
3. Këto projekte do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2022.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

- 5 Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR I KËSHILLIT

Mark Bisha

SEKRETARI KËSHILLIT

Ardian Çelepija

Miratur me 22 vota.

Vota Pro 21.

Vota Kundër 1 (një).

Vota Abstenim —.

Zbardhur me datë 01 . 06 . 2022.